

VENDIM
Nr. 198, datë 22.2.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 13, DATË 7.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË DËRGUAR NË BOSNJË-HERCEGOVINË, NË KUADËR TË
OPERACIONIT USHTARAK “ALTHEA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të aktit normativ nr. 2, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit European, miratuar me ligjin nr. 9907, datë 24.4.2008, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr. 13, datë 7.1.2010 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Kohëzgjatja e misionit të jetë deri në fund të vitit 2013, me rotacion çdo 6 (gjashtë) muaj. Rotacionit i shtohet edhe koha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha